

## PROCESVERBAL

nga seanca e dytë e Këshillit të Agjencisë për Shërbime

Mediatike Audio dhe Audiovizuale

mbajtur më 21.01.2025

**Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë:** Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, Llazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

**Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /**

**Në seancë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.**

**Të pranishëm nga Shërbimi Profesional:** mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, Magdalena D.dovleva , Emilija Janevska, Maja Damevska.

**Të pranishmit e tjerë:/**

Kryetari i Këshillit, Lazo Petrushevski hapi seancën e dytë të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 13:35 dhe u mbajt në ambientet e ASHMA-së, salla e konferencave, kati i dytë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 6 vota "pro", miratoi sa vijon:

### RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga vazhdimi i parë i seancës së 47-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 02.01.2025.
2. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e parë e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 02.01.2025.
3. Propozim-rregullore për regjistrimin e ofruesve të shërbimit të platformës për ndarjen e videove.
4. Propozim-vendim për anulimin e Vendimit me të cilin lejohet ndryshimi në strukturën e pronësisë të transmetuesit.
5. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR SPEKTRA, Komuna Labunishtë SHPKNJP, për shkelje të nenit 64 paragrafi (1) të LSHMAAV.
6. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR SPEKTRA, Komuna Labunishtë SHPKNJP, për shkelje të nenit 92 paragrafi (1) të LSHMAAV.
7. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar, për shkelje të nenit 51 paragrafi (1) të LSHMAAV.

8. Propozim-aktvendim për fshirje nga regjistri i transmetuesve të Njesisë Organizative Radiodifuzive Jofitimprurëse RADIO UNIVERSITARE STUDENT FM 92.9.

9. Propozim-aktvendim për fshirje nga regjistri i transmetuesve të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë.

10. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim : Shërbim nga agjenci private për punësim.

11. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: Shërbime revizioni.

12. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: Bileta avioni.

13. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: Shërbime të sigurimit financiar.

14. Të ndryshme.

### **Pika 1**

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe me 6 vota “pro” miratoi Procesverbalin e propozuar nga vazhdimi i parë i seancës së 47-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më datë 02.01.2025, me tekstin e propozuar.

### **Pika 2**

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe me 6 vota “pro” miratoi Procesverbalin e propozuar nga seanca e parë e rregullt të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 02.01.2025, me tekstin e propozuar.

### **Pika 3**

Udhëheqësja e Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit, Magdalena D. Dovleva, prezantoi Propozim-rregulloren për regjistrimin e ofruesve të shërbimeve platformë për ndarjen e videove. Ajo shpjegoi se nevoja për miratimin e Rregullores buron nga neni 144b të Ligjit për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizuale, i cili përcakton kompetencën e Agjencisë për të përcaktuar formën dhe përmbajtjen e Formularit të aplikimit për ofruesit e shërbimeve platformë për shkëmbim të videove. Këta ofrues detyrohen t'i paraqesin dokumentet e nevojshme për regjistrim në regjistër, gjë që është parakusht për fillimin e veprimtarisë së tyre. Aktualisht, nuk ka asnjë ofrues të këtij shërbimi që është nën juridiksionin tonë. Ajo theksoi se janë ndërmarrë të gjitha aktivitetet e nevojshme për përmbushjen e këtij detyrimi ligjor, për hartimin dhe miratimin e Rregullores, si dhe për sigurimin e kushteve për kryerjen e rregullt të kësaj veprimtarie. Draft-version i Rregullores është miratuar më 12 dhjetor të vitit të kaluar. Debati publik për tekstin ka përfunduar, dhe nuk është paraqitur asnjë vërejtje. Kështu teksti i paraqitur është, në formën e tij përfundimtare, identik me versionin e miratuar më parë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Rregulloren për regjistrimin e ofruesve të shërbimeve platformë për ndarjen e videove, me tekstin e propozuar.

Sektorit për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Rregulloren për regjistrimin e ofruesve të shërbimit platformë për ndarjen e videove do ta publikon në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut” dhe në ueb-faqen e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

#### Pika 4

Z. Trajçevski theksoi se pikërisht para dhjetë muajsh është marrë Vendim për ndryshimin e strukturës së pronësisë të televizionit Klan. Fatkeqësisht, edhe pas dhjetë muajve të kaluar, ky ndryshim ende nuk është zbatuar në Regjistrin Qendror. Formalisht, gjëndja në regjistër ende pasqyron strukturën e mëparshme të pronësisë, që do të thotë se ndryshimi nuk është realizuar zyrtarisht. Në muajin qershor të vitit të kaluar, është dërguar njoftim drejtuar televizionit Klan, për të përcaktuar arsyet e mosrealizimit të ndryshimit. Në përgjigje, ata raportuan se aktivitetet për realizimin e ndryshimit janë duke u zhvilluar dhe se e njëjta do të realizohet sa më shpejt që të jetë e mundur. Mirëpo, disa muaj më vonë, përsëri u konstatua se Vendimi i Këshillit të ASHMA-së ende nuk ishte zbatuar. Në dhjetor, televizioni është njoftuar sërish dhe është thirrur që në afatin e arsyeshëm të zbatojë vendimin e miratuar. Megjithatë, deri më sot, për njoftimin dhe kërkesën tonë për realizim nuk është marrë asnjë përgjigje. Moszbatimi i këtij vendimi pas një periudhe kohore shtron pyetje për ligjshmërinë e vendimit të miratuar fillimisht. Gjegjësisht, mund të ketë ndodhur ndryshim i gjendjes faktike, për shkak se kushtet që janë plotësuar në momentin e marrjes së Vendimit ndoshta tashmë nuk janë relevante. Kontrollat e rregullta të ASHMA-së për përmbushjen e kushteve për shmangien e përqendrimit mediatic kanë shkaktuar një barrë financiare plotësuese për institucionin. Duke qenë se Vendimi i Këshillit të ASHMA-së nuk është zbatuar në Regjistrin Qendror dhe se nuk ka asnjë nismë nga Televizioni Klan për realizimin e tij, propozohet që Këshilli të anulojë vendimin për ndryshimin e strukturës së pronësisë.

Z. Trajçev tha, siç theksoi drejtori, se të gjitha afatet e arsyeshme kanë kalua, por përkundër kësaj, Agjencia vazhdon t'i bartë shpenzimet për shkak të moszbatimit të Vendimit të Këshillit të ASHMA-së. Në anën tjetër, u theksua se mund të ketë nevojë sërish të rishqyrtohet dhe rishikohet vetë Vendimi. Kjo do të përfshinte një rishikim të kujdesshëm në përputhje me dispozitat ligjore, në mënyrë që të adresohen situatat dhe problemet e mundshme. Ai propozoi që shërbimet profesionale të gjejnë formulim të duhur dhe të saktë të Vendimit, i cili do të mund të zbatohet në mënyrë më efikase. Është e rëndësishme të merren parasysh të gjitha aspektet për të gjetur zgjidhjen më të mirë, e cila do të zbatohet në mënyrë efektive, në përputhje me rrethanat ligjore dhe praktike.

Z. Zoran Fidanoski e pyeti z. Trajçev nëse propozon të refuzohet formulimi “anulim” nga dispozitivi i Vendimit?

Z. Trajçev theksoi se Vendimi duhet të përpunohet, dhe shërbimet profesionale do të duhet të përcaktojnë mënyrën më të përshtatshme për ta bërë këtë. Ai theksoi se ky formulim në formën aktuale nuk është i pranueshëm dhe se duhet gjetur një zgjidhje më e plotë dhe efektive. Sipas tij, Vendimi nuk mund të mbetet në formën aktuale për një kohë të gjatë.

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik, Cvetanka Mitrevska shpjegoi se gjatë shqyrtimit të mundësive për anulimin e Vendimit, e kanë pasur parasysh edhe nenin 42 të LSHMAAV, i cili është përmendur në diskutim. Ajo shpjegoi se kushtet e përcaktuara në këtë nen nuk ishin të zbatueshme në situatën konkrete. Sipas nenit 42 të LSHMAAV, Agjencia mund të anulojë Vendimin për zbatimin e ndryshimit të strukturës së pronësisë vetëm nëse ai është miratuar në bazë të të dhënave të pasakta ose jo të plota, për të cilat përgjegjësia do të ishte e transmetuesit. Mitrevska ka theksuar se një situatë e tillë nuk ka ekzistuar në momentin kur është marrë Vendimi për ndryshimin e strukturës së pronësisë. Ajo shtoi se edhe pse janë duke u rishqyrtuar këtë mundësi, arsyet e përcaktuara në nenin 42 ende nuk janë të zbatueshme në këtë rast.

Z. Trajçev shpjegoi se nuk propozon që të ndiqet neni 42, por ai nen parasheh vetëm se cilat situata mund të çojnë në anulimin e Vendimit. Sipas interpretimit të tij, në këtë situatë konkrete nuk ka kushte për anulimin e Vendimit në pajtim me nenin 42, prandaj vendimi nuk mund të anulohet. Ai propozoi që të gjendet një zgjidhje tjetër, siç është shfuqizimi i Vendimit. Si qëllim përfundimtar duhet të merret një vendim i duhur që do të jetë në përputhje me ligjet. Trajçev theksoi se ky Vendim nuk është në përputhje me nenin 42, i cili përcakton arsyet për anulim dhe ofroi sugjerimin e tij për gjetjen e formulimit të duhur për zgjidhjen e problemit.

Z. Fidanoski prezantoi interpretimin e tij për propozimin e kolegut Trajçev, sipas të cilit propozohet anulimi ose shfuqizimi i vendimit. Sipas Fidanoskit , kjo do t'i mundësonte Këshillit të marrë një vendim të ri. Ai theksoi se kjo zgjidhje është përgjithësisht e pranueshme për të. Ai propozoi që Vendimi të përgatitet për seancën e ardhshme, në mënyrë që të arrihet unanimiteti i anëtarëve të Këshillit dhe të vazhdohet me ndjekjen e procedurave në përputhje me rregulloret.

Z. Trajçev gjithashtu propozoi që kur në të ardhmen të merren vendime për miratimin e ndryshimeve në strukturën e pronësisë, të caktohet një afat konkret për zbatimin e këtyre ndryshimeve. Në situatën aktuale nuk ishte caktuar afat për zbatimin e Vendimit. Agjencia vuri në dukje se kishte një situatë në të cilën nuk ishte ndërmarrë asnjë veprimtari për 10 muaj, gjë që krijoi probleme dhe vonesa në procedura. Prandaj, ai theksoi se duhet të vendosen afate që situata të tilla të mos përsëriten në të ardhmen dhe të sigurohet që proceset të përfundojnë brenda një kohe të arsyeshme.

Z. Jançeski theksoi se kjo gjendje në të cilën ata janë tani është rasti i parë i tillë në dhjetë vitet e fundit dhe buron nga paqartësitë në ligj. Ai propozoi identifikimin e zbrazëtirave të tilla dhe të ngjashme në dispozitat ligjore që pengojnë veprimin e shpejtë dhe efikas. Është e nevojshme të paraqitet propozimi në Kuvend për ndryshimin e LSHMAAV në mënyrë që situata të tilla të rregullohen saktësisht. Është e nevojshme të kufizohet koha e përgjigjes të transmetuesve, sepse nuk mund t'i lëmë hapësirë pafund reagimit të tyre. Propozohet që këto ndryshime të jenë pjesë përbërëse e Ligjit, për të shmangur situata të tilla të paspecifikuara. Gjithashtu, të gjitha mospërputhjet, paplotësitë dhe pasaktësitë që ata kanë vënë re në punën e tyre ndër vite duhet të shqyrtohen si paketë dhe t'i dorëzohen Kuvendit për të kërkuar zgjidhjen e tyre përmes ndryshimeve përkatëse të dispozitave ligjore. Kjo do të kontribuojë në punë më efikase, ekonomike dhe më të organizuar, pasi mangësi të tilla sjellin shpenzime shtesë dhe krijojnë pengesa të panevojshme në kryerjen e aktiviteteve.

Z. Petrushevski theksoi se Agjencia gjatë viteve të kaluara ka pasur propozime të ngjashme. Ai rekomandoi që diskutimi i kolegut Jançeski të merret parasysh në diskutimet dhe vendimet e ardhshme. Edhe pse Agjencia drejtpërdrejt nuk paraqet propozime në Kuvend, mendon se përmes bashkëpunimit me Ministrinë mund të inicohet propozim për riformulimin dhe sqarimin e çështjeve të përmendura nga z. Jançevski. Ka shumë situata të ngjashme në ligjet që Agjencia rregullisht i ka vërejtur dhe vënë në dukje. Megjithatë, mbetet e pasigurt nëse këto propozime do të pranohen apo do të shqyrtohen.

Z. Ajdini deklaroi se i kishte shqyrtuar të gjithë shkresat me transmetuesin në mënyrë kronologjike dhe theksoi se si anëtar i Këshillit disa herë ka tentuar të kontaktojë me përfaqësuesit e Televizionit SHTR KLAN. Arsyet pse televizioni nuk ka mundur të realizon ndryshimin e strukturës së pronësisë mbetën të panjohura dhe nuk ishin në kompetencën e tyre. Ai shprehu keqardhjen që për më shumë se 10 muaj televizioni nuk arriti të realizonte ndryshimin e strukturës së pronësisë. Ai u pajtua me propozimin e kolegut Trajçev. Përveç

kësaj, ai ka vërejtur se në faqen 14 të materialit të përgjithshëm kishte një gabim teknik, ku shkruhej " R. Albanija , Prishtinë". Ai ka theksuar se kjo është dashur të korrigjohet në " R. Shqipërisë , Tiranë" apo " R. Kosova , Prishtinë", për të shmangur çdo ngatërresë.

Z. Petrushevski e përmbodhi diskutimin e seancës dhe theksoi se të gjithë janë të pajtimit që vendimi nuk duhet të merret në atë moment. Ai propozoi që Këshilli të miratojë Konkluzion sipas të cilit materiali do të përpunohet dhe finalizohet më tej. Materiali do të rishikohet dhe do të prezantohet në seancën e ardhshme.

Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale njëzëri miratoi Konkluzion për saktësimin dhe finalizimin e mëtejshëm të Vendimit për anulimin e Vendimit PA1 nr.02-74, datë 21.03.2024. e cila mundëson ndryshimin e strukturës së pronësisë së SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport-import Saraj Shkup.

### **Pika 5 dhe 6**

Kryetari i Këshillit, Lazo Petrushevski, propozoi që Pikat 5 dhe 6 të shpjegohen në një hyrje dhe një diskutim të përbashkët, pasi bëhet fjalë për të të njëjtin transmetues dhe më pas të votohet për secilën veç e veç.

Udhëheqësja e Sektorit për çështje programore, Emilija Janevska, prezantoi Raportet e mbikëqyrjes, të kryera në nëntor 2024, të cilat kanë të bëjnë me shkeljet në TV Spektra. Shkelja e parë i referohet nenit 64 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, sipas të cilit programet duhet të transmetohen në gjuhën maqedonase ose në gjuhën e bashkësisë me përkthim. Mbikëqyrja konstatoi transmetim në gjuhën serbe, anglisht dhe shqip pa përkthim në maqedonisht. Propozohet masë vërejtje publike me afat prej 10-ditësh për harmonizim.

Shkelja e dytë është e nenit 92 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, i cili kërkon minimum 30% vepra audiovizuale maqedonase në program. Është konstatuar se TV Spektra ka transmetuar 21.91%, që është dukshëm më pak se sa kërkohet. Janevska përfundoi me propozimin për shqiptimin e masave dhe kontrole për verifikimin e harmonizimit.

### **Votimi për pikën 5**

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore, nr.4790/1, datë 19.11.2024 dhe njëzëri konstatoi që SHTR SPEKTRA, Komuna Labunishtë SHPKNJP, t'i shqiptohet masë vërejtje publike për shkelje të nenit 64 paragrafi (1) të LSHMAAV, sepse më 04.11.2024, në disa përmbajtje programore janë transmetuar pjesë të fjalës në gjuhë të huaja (serbisht, anglisht ose shqip), pa përkthim në gjuhën maqedonase.

Në përputhje me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) nr.01-4139/1, datë 07.11.2022, urdhërohet që në afat prej 10 ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit, të harmonizon punën e tij me dispozitat e nenit 64 paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Sektori për çështje juridike dhe furnizim publik, është i detyruar të përgatisë Aktvendimin për shqiptimin e masës vërejtje publike transmetuesit në fjalë.

Sektori për çështje programore është i detyruar që pas skadimit të afatit përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike, të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti

i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas me masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht apo nuk veproj).

Spektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, është i detyruar që aktvendimin e lartpërmendur ta publikon në ueb-faqen e Agjencisë.

#### Votimi për pikën 6

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore, nr.10-4739/1, datë 19.11.2024 dhe njëzëri konstatoi që SHTR SPEKTRA, Komuna Labunishtë SHPKNJ t'i shqiptohet masë vërejtje publike për shkelje të nenit 92, paragrafi (1) të LSHMAAV, sepse më 4 nëntor 2024, nuk ka transmetuar së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase.

Në përputhje me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) nr.01-4139/1, datë 07.11.2022, urdhërohet që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e nenit 92 paragrafi (1) të ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Spektori për çështje juridike dhe furnizim publik është i detyruar që të përgatisë Aktvendimin për shqiptimin e masës vërejtje publike transmetuesit në fjalë.

Spektori për çështje programore është i detyruar që pas skadimit të afatit përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike, të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht apo nuk veproj).

Spektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, është i detyruar që aktvendimin e lartpërmendur ta publikon në ueb-faqen e Agjencisë.

#### **Pika 7**

Udhëheqësja e Sektorit për çështje programore, Emilija Janevska, shpjegoi se shkelja e transmetuesit TV DUE është konstatuar në kuadër të mbikëqyrjes së rregullt administrative të kryer në nëntor të vitit 2024. Sipas nenit 51 paragrafi (1) të LSHMAAV, transmetuesit janë të detyruar të ofrojnë informacione që do të jenë lehtësisht të disponueshme për përdoruesit në mënyrë të qartë, të drejtpërdrejtë dhe të përhershme. Këto informacione duhet të përfshijë: emrin e plotë të ofruesit të shërbimit, adresën e selisë, të dhëna për kontakt dhe informacionin për organin rregullator përkatës. Gjatë mbikëqyrjes së kryer është konstatuar se TV DUE nuk i përmbush këto detyrime, përkatësisht nuk ofron informacionin e nevojshëm në kuadër të programit. Për shkak të këtyre lëshimeve, propozohet shqiptimi i masës – vërejtje publike, me afat për harmonizim prej 20 ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit. Pas skadimit të këtij afati do të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse transmetuesi ka respektuar masën e shqiptuar.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt administrative, nr.10-4887/1 datë 21.11.2024 dhe njëzëri konkludoi që SHTR TV DUE Nazmi SHPKNJ Gostivar t'i shqipton masë vërejtje publike për shkelje të nenit 51 paragrafi (1) të LSHMAAV, sepse në 04 nëntor 2024, nuk ka ofruar informacion që duhet t'u vihet në dispozicion përdoruesve.

Në përputhje me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masave nr.01-4139/1, datë 07.11.2022, është i

detyruar që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Sektorii për çështje juridike dhe furnizim publik të përgatisë Akvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike transmetuesit në fjalë.

Sektorii për çështje programore, pas skadimit të afatit përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike të kryen mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht ose nuk veproj).

Sektorii për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin e lartpërmendur ta publikon në ueb-faqen e Agjencisë.

#### **Pika 8**

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe me 5 vota "pro" dhe një abstenim nga z.Jançeski, miratoi Akvendim për fshirjen nga regjistri i transmetuesve për "Shn.Kirili dhe Metodi" në Shkup - Njësia organizative radiodifuzive jofitimprurëse RADIO UNIVERSITARE STUDENT FM 92.9 .

Sektorii për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e lartpërmendur ta publikon në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" dhe në ueb-faqen e Agjencisë.

#### **Pika 9**

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Aktvendim për fshirjen nga regjistri i transmetuesve të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë.

Sektorii për mbështetje të punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e lartpërmendur ta publikon në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" dhe në ueb-faqen e Agjencisë.

#### **Pika 10**

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik, Cvetanka Mitrevska shpjegoi Propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Shërbimi nga agjencia private për punësim. Ajo theksoi se furnizimet publike për vitin 2025 fillojnë të realizohen në pajtim me Planin vjetor për furnizim publik, si dhe kornizës së duhur financiare për vitin e planifikimit. Në kuadër të këtyre furnizimeve është planifikuar shërbimi nga një agjenci private punësimi, me qëllim plotësimin e nevojave të Agjencisë për plotësimin e vendeve të caktuara të punës që mund të paraqiten si të domosdoshme gjatë vitit, veçanërisht për faktin se ky është vit zgjedhor. Furnizimi do të kryhet në përputhje me dispozitat e Ligjit për furnizime publike, duke përdorur procedurë të hapur. Procedura do të fillojë me shpalljen e njoftimi publik. Për shkak të procedurës së hapur, shpallja do të publikohet në sistemin elektronik për furnizime publike, në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë, si dhe në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian. Të gjitha informatat dhe detajet shtesë rreth këtij furnizimi publik gjenden në materialet e ofruara anëtarëve të Këshillit për këtë seancë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratim për zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: Shërbim nga agjenci private për punësim.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën-shërbim: Shërbim nga agjenci private për punësim, është parashikuar dhe është në përputhje me Planin vjetor për furnizim publik për vitin 2025 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, ndërsa mjetet sigurohen nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2025.

#### **Pika 11**

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik Cvetanka Mitrevska, shpjegoi Propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik – shërbim: Shërbime revizioni. Ajo theksoi se Agjencia ka detyrim ligjor që të dorëzojë raport revizioni në Kuvend, i cili do të përgatitet nga Shoqëri revizioni e autorizuar. Për këtë do të realizohet procedurë për furnizim publik, në përputhje me Ligjin për furnizim publik, dhe duke qenë se bëhet fjalë për furnizim me vlerë të ulët, procedura do të kryhet përmes shpalljes së njoftimit në sistemin elektronik për furnizim publik. Informata shtesë për këtë furnizim gjenden në materialet e ofruara anëtarëve të Këshillit për këtë seancë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratim për zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: Shërbime revizioni.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën-shërbim: Shërbim revizioni, është parashikuar dhe është në përputhje me Planin vjetor për furnizim publik për vitin 2025 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, ndërsa mjetet sigurohen nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2025.

#### **Pika 12**

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik Cvetanka Mitrevska, shpjegoi Propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Bileta avioni. Ajo theksoi se si furnizimet e mëparshme, edhe ky, si dhe furnizimet në vijim, janë pjesë e Planit vjetor për furnizim publik të Agjencisë dhe mjetet e nevojshme janë paraparë në planin financiar. Ky furnizim konkret është destinuar për ofrimin e shërbimit për bileta avioni, sipas kërkesave të Agjencisë. Duke pasur parasysh vlerën e parashikuar të këtij furnizimi, ai do të realizohet përmes një procedure të hapur të thjeshtuar, në përputhje me Ligjin për furnizim publik. Procesi do të fillojë me shpalljen e njoftimit në Sistemin Elektronik për furnizime publike (SEFP) dhe në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratim për zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: Bileta avioni.

#### **Pika 13**

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik Cvetanka Mitrevska, shpjegoi Propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: Shërbime të sigurimit financiar. Ajo theksoi se edhe ky furnizim, sikurse edhe të mëparshmit, është i paraparë në Planin vjetor për furnizim publik dhe Planin financiar të Agjencisë. Këto dy elemente – planifikimi në planin vjetor dhe sigurimi i mjeteve në planin financiar – janë parakushtet bazë që duhet të plotësohen për të filluar çdo procedurë për furnizim publik. Furnizimi do të kryhet si procedurë me vlerë të ulët, duke shpallur njoftim në Sistemin Elektronik për Furnizim Publik (SEFP). Procesi do të fillojë pasi të përfundojë inventari dhe do të dihen të gjitha të dhënat për mjetet e vlerësuara që do të nevojiten.



Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratim për zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: Shërbime të sigurimit financiar.

**Pika 14**

**Të ndryshme**

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**